



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:028819  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05477548

**Ac.nr.3321/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit Sh.M. me vendbanim në Rr. "...", pn. Komuna Mitrovicë te cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.Q., kundër të paditurës PTK me seli në Komuna Prishtinë, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Naim Rexha, në çështjen kontestimore për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.110/2012 datë 15.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.03.2024, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e të paditurës PTK me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.110/2012 datë 15.02.2021, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.110/2012 datë 15.02.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon : "...*APROVOHET si bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.M. nga Mitrovica, ANULOHET aktvendimi i të paditurës PTKnr.1040-1050 i datës 07.03.2012, me te cilin paditësit i është zvogëluar grada nga 8 në 7.*

*DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e burnusit në mes të gradës 7 dhe 8 për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012 e*

*deri më 01.09.2015, në shumë prej 4,575.56 € (Katerëmijë e pesëqind e shtatedhjetë e pese euro e spesedhjetë e gjashtë cent), në emër të trustit pensional shumë të shumën prej 228,77 € (Dyqinde e njizete e tete euro e shtatëdhjetë e shtat cent), dhe në emër të kamatës për periudhën 2012-2019 shumen prej 2,121.87 € (Dymijë e njëqinde e njëzet e një euro e tetëdhjetë e shtate cent), apo shumen e përgjithshme prej 7,399.36 €, (Shtatemije e treqinde e nentëdhjetë e nente euro e tridhjetë e gjashtë cent), të gjitha këto me kamat vjetore sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim të caktuar duke filluar nga data 16.05.2012 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditorë nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm...”.*

Kundër Aktgjykimit C.nr.110/2012 datë 15.02.2021, të marrë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, në afat ligjor e paditura, ka paraqitur ankesë, duke e atakuar Aktgjykimin për shkak të: *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës ashtu që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ose ta prish dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi me propozim Gjykatës së Apelit që ta refuzojë ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

***-Ankesa është e pathemeltë.***

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi Sh.M. me vendbanim në Rr.”...”pn. Komuna Mitrovicë, ka parashtruar padi në Gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në Prishtinë, duke kërkuar kompensimin e diferencës së pagës.

Gjykata e shkallës së parë, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 30.09.2020, dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, dhe administrimit të provave, ka marrë Aktgjykimin C.nr.110/2012 datë 15.02.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

*Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se: “... Gjykata duke u mbështetur në rregullat e lartcekura për arsye se palët kanë lidhur kontratë me kohë të pacaktuar dhe rrjedhimisht kanë detyrim që në kohë të pacaktuar aq sa zgjat kontrata tu përmbahen kushteve të kontratës duke përmbushur detyrimet reciproke, andaj e aprovoj padinë e paditëses dhe e anuloj si të kundërligjshëm vendimin të paditurës PTKnr.1040-1050 i datës 07.03.2012 si në pikën I të dispozitivit, e rrjedhimisht me aprovimin e padis gjykata e obligoj të paditurin për*

*periudhën nga 01.02.2012 e deri me datë 01.09.2015 në emër të kompensimit të diferencës në page duke u bazuar dhe në ekspertizën financiare të cilës gjykata l'a fali besimin e plotë, ti'a paguaj paditëses shumën prej në shumë prej 4,575.56 €, në emër të trustit pensional shumën prej 228,77 €, dhe në emër të kamatës për periudhën 2012-2019 shumen prej 2,121.87 €, apo shumen e përgjithshme prej 7,399.36 €, të gjitha këto me kamat vjetore sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim të caktuar duke filluar nga data 16.05.2012 e deri në pagesën definitive të detyrimit. Lidhur me kamat gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 277 të Ligjit të vjetër të Marrëdhënieve të Detyrimeve...”.*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n), e LPK-së, nga se, sipas të paditurës dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i kjashtë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë për vendosje meritore.

E drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 7 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të të paditurit, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në

raport me të hyrat e përgjithshme të të paditurit për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit pasi që në rekomandimin e Ministrisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ka prova se i padituri Telekom i Kosovës sh.a. ka bërë ndërhyrje në aktet normative të tij lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues. Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale duke ju referuar në arsyetim të aktgjykimit dispozitës së nenit 55 paragrafi 1, të Ligjit të Punës, e cila përcakton së: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*. Në këtë rast punëdhënësi dhe punëmarrësi me kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar përveç tjerave edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Përkritazi me lartësinë e aprovuar të kërkesëpadisë në mes të gradës 8 dhe 7 Gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës materiale ka nxjerrë ekspertizën financiare të datës 20.05.2019, të punuar nga eksperti M.F., me të cilën e ka vërtetuar lartësinë e diferencës së të ardhurave që do ta realizonte paditësi në mes të gradës 8 dhe 7 sikurse të mos i ishte zbritur me vendim të kundërligjshëm. Në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sa i përket lartësisë së të ardhurave personale të paditësit në mes gradës 8 dhe 7 dhe atë për ndryshimin e pagës, kontributit dhe të trustit.

Pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata duke marrë parasysh suksesin e arritur në Gjykatë të caktoj që secila palë ti bartë shpenzimet e veta, ky pretendim është i pa bazuar pasi që në piken III të aktgjykimit të atakuar në mënyrë decitive thuhet se *“Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale”*.

Lidhur me kompensimin e shumëës për paditësin të vendosur nga Gjykata e shkallës së parë, edhe në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në rastin Klass kundër Gjermanisë në Aktgjykimin e 6 shtatorit 1978 ndër të tjera thuhet se *“...kur një person konsideron se është paragjykuar përmes një akti për të cilin pretendon se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të këtë në dispozicion një mjet juridik para autoriteteve shtetërore, që do i mundësojë zgjidhjen e kërkesës së tij dhe, nëse duhet, ofrimin e kompensimit”*, ndërsa në nenin 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut ndër të tjera thuhet se *“...Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar...”*.

Në nenin 49 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë decitive thuhet se *“E drejta e punës garantohet”*.

Sa i përket vendosjes nga gjykata e shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës, i njëjti është i bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni/ve 194, 195 paragrafi 1 pika (d), nenin 200 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, nenin/et 49 par.1, dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.3321/21 datë 18.03.2024**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,  
Bujar Muzaqi**